



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr./No.org. Org./edinica Org./Unit	Nr./Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr./Faqeve Br./Stranica No./Pages	Date: Datum: Date:
PRISHTINË / A	
No. 1	

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.016-74231 me të cilin bëhet ndryshimi i emërimit të pronave të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronave në librin kadastral, pasi që në certifikatën e pronësisë figurojnë me emërtime të vjetra

I nderuar kryetar Muharremaj,
I nderuar kryesues Kuqi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr.016-74231 me të cilin bëhet ndryshimi i emërimit të pronave të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronave në librin kadastral, pasi që në certifikatën e pronësisë figurojnë me emërtime të vjetra, miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, datë 27.11.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Suharekës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi Nr.016-74231 me të cilin bëhet ndryshimi i emërimit të pronave të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronave në librin kadastral, pasi që në certifikatën e pronësisë figurojnë me emërtime të vjetra, miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, datë 27.11.2023.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.016-74231 me të cilin bëhet ndryshimi i emërimit të pronave të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronave në librin kadastral, pasi që në certifikatën e pronësisë figurojnë me emërtime të vjetra, konstatoi se:

Hyrja e vendimit është bazuar vetëm në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës së Suharekës, mirëpo i mungon baza ligjore nga ku buron e drejta e miratimit të vendimit Nr.016-74231.

Gjithashtu, me rastin e administrimit të dokumenteve të cilat gjenden në lëndë dhe shqyrtimit të përmbajtjes së vendimit krijohet paqartësi pasi që nuk mund të konstatohet se a ka të bëjë me ndërrimin e emërimit të shkollave apo titullarit të pronës.

Po ashtu, vendimi duhet të përmbaj shprehimisht të dhënat gjegjësisht emërtimet e shkollave të cilat pretendoni t'i ndryshoni.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

